

ERJENA (CENKA) LAMAJ

**DIMENSIONE TË INJORUARA DHE VLERA
TË ANASHKALUARA TË NJË KRIJUESI
DHE TË VEPRËS SË TIJ LETRARO-ARTISTIKE**

Ky punim i kushtohet një figure sa të njohur aq dhe të panjohur të letërsisë tonë nga lexuesi shqiptar. Fjala është për shkrimtarin Etëhem Haxhiademi, një ndër ata krijues që sot përmendet me emërtime të ndryshme, si: autor i ndaluar, autor i panjohur ose autor i persekutuar nga regjimi komunist. Parë thjesht si emërtime a si epitete, do të thoshim se pak rëndësi kanë epitetet që iu janë vënë atyre nga kritika a studiuesit e sotëm, edhe pse secili prej tyre është përdorur mbi bazën e një konotacioni e qëllimi të caktuar.

Sipas nesh, rëndësia kryesore, qëndron se kush janë dhe ç'përfaqësojnë për letërsinë e kulturën tonë këta krijues, qoftë në tërësinë e tyre, qoftë si individë e si individualitete.

Nëse këtë identitet do ta kërkonim për Etëhem Haxhiademin, nëpërmjet shkrimeve të ndryshme nëpër gazetatat e kohës ose materialeve që ndodhen në arkivat tona do të mësonim një sërë faktesh për të, si kohën dhe vendin e lindjes, formimin arsimor dhe edukimin e tij, punësimin e jetën e tij në përgjithësi, si në planin personal, ashtu dhe atë social.

Nga këto mësojmë se Etëhemi lindi në Elbasan në 8 Mars, të vitit 1902. Shkollimi i tij nis në vendlindje, madje ndër nxënësit e parë të Normales së Elbasanit dhe vazhdon me studimet e larta jashtë atdheut: Itali, Austri dhe Gjermani, pas të cilave ai kthehet në Shqipëri në fillim të viteve '30 i diplomuar

për shkencat politiko-juridike. Fillimi i viteve '30 krahas përfundimit të studimeve dhe diplomimit, shënon dhe një fakt tjetër i cili lidhet me shpalosjen e shkëndijave të para të talentit të tij në fushën e letërsisë. Për shkak të prirjeve në këtë fushë, bindjeve të tij që herë - herë shkonin ndesh me ligjet e regjimit të kohës dhe disa arsyeve të tjera individuale, të tij, Haxhiademi i shmanget për të mos thënë nuk pranon emërimin në administratë që i ofroi regjimi, veprim i cili nuk shihet mirë dhe pas një periudhe të shkurtër ai e sheh veten të burgosur. Ishte viti 1946.

Por, njëkohësisht ky ishte dhe fillimi i kalvarit të vuajtjeve të tij.

Por, nga ana tjetër, kjo as e frenoi dhe as e largoi nga aktiviteti i tij si intelektual e atdhetar, por dhe si krijues. Ai vazhdoi rrugën e tij si një krijues i talentuar, i veçantë dhe i suksesshëm, për llojin e krijimtarisë të cilës iu përkushtua e cila fatkeqësisht ndërpritet dhunshëm edhe nga regjimi i ri që u vendos.

Themi i veçantë për shkak se, në kuadrin e veprës së tij, krahas krijimeve poetike, shkrimeve publicistike e përkthimeve, në bagazhin krijues të Etëhem Haxhiademit kemi, jo pak por shtatë vepra dramatike, madje shtatë tragjedi. Sigurisht nuk e përmendim këtë fakt për të dëshmuar se që i pari që shkroi në fushën e dramaturgjisë por se Haxhiademi, që jo rrallë e kanë quajtur dhe *Sofokliu shqiptar*, ai renditet ndër krijuesit e suksesshëm në këtë gjini, krahas De Radës, Fishtës, Gramenos, etj.

Në këtë kontekst, Haxhiademi ka vlerat e veta dhe, në anën tjetër, duhet të nënvizojmë faktin se vepra e tij ndoqi dhe u bë përçuese e tipareve neoklasiciste të dramatikës, të nisura dhe të fituara në dramatikën tonë të kohës nga De Rada dhe Fishta.

Me të drejtë sollëm pak më lartë faktin se Haxhiademi që krijues, prodhimtar por dhe i suksesshëm në veprën e tij. Atëherë na lind pyetja: Për cilat arsye ai nuk u vlerësua sa dhe si duhet në

regjimin e Zogut dhe pse e mbuloi harresa nën vitet e regjimit komunist?!

Duke shfletuar shkrimet e shënimet e ndryshme të gjendura nëpër faqet e shtypit dhe materialet arkivore të kohës, njihesh me argumente dhe justifikime që për arsye të shumëllojshme e nga më të çuditshmet, përpiqen të hedhin dritë në këtë drejtim. Diku nxjerrin si argument nivelin jo të pëlqyeshëm cilësor të tragjedit, diku flasin për praninë e një tematike anakronike, për realizim e paraqitje jobindëse të karaktereve, tipologjizim jo të saktë të dramave, etj.

Parë në një këndvështrim tjetër, vihet re se Haxhiademi nuk ishte viktimë e veprës së tij, mangësitë e së cilës mbeten, në fund të fundit brenda planit teknik. Ai nuk u pranua nga të dy regjimet edhe për një arsye tjetër. Haxhiademi si në kohën e Zogut, ashtu dhe në kohën e diktaturës komuniste, pësoi dhe vuajti edhe për shkak të bindjeve të tij politike e ideologjike, të cilat, në të dy periudhat, manifestonin një qëndrim të hapur kundër zogizmit, fashizmit e komunizmit. Madje duhet theksua se, me qëndrimet e tij, ai pësoi më tepër nga qëndrimi antikomunist, qëndrim i cili i kushtoi plot 19 vjet të jetës së tij. Ishte ky regjim që nuk ia pëlqeu e as ia pranoi Haxhiademit qëndrimin e theksuar atdhetar, formimin e shquar intelektual, personalitetin imponues dhe karakterin e fuqishëm. Por nuk i pëlqeu as tipin e shkrimtarit “tradicionalist”, “fetar”, “jorealit”, e “reaksionar” të cilat, sigurisht shkonin ndesh me normat e parimet e kohës. Regjimet që pati fatin e keq Haxhiademi të jetojë nuk mund të qenë kurrsesi miqtë e tij. Ato qenë sisteme e regjime që nuk kishin interes ta përkrahnin e ta propagandonin veprën e Haxhiademit. Interesi i tyre ishte ta dëmtonin e ta luftonin atë, ta kalonin në heshtje dhe, kur të ishte e nevojshme, ta zhduknin atë, siç ndodhi me një roman e një dramë të cilat humbën jo rastësisht dhe, për fat iu mbeti vetëm titulli.

Nëse autori u persekutua fizikisht, vepra e tij u botua pjesërisht dhe, më vonë, çuditërisht u zhduk nga qarkullimi për

një periudhë 50-vjeçare e cila nuk pa as dhe një herë të vetme skenën e teatrit.

Sidoqoftë, koha është ajo që një ditë e vendos drejtësinë në vendin që i takon, që të harron padrejtësisht por një ditë të kujton e ta jep vendin e merituar dhe përjetësinë e dhunuar.

Injorimin, denigrimin dhe harresën nuk ta japin as juritë, as pseudokritizerët e as burokratët por lexuesi i gjerë dhe populli bir apo bijë e të cilit je.

Përmendëm pak më sipër se vepra e Haxhiademit përmbledh një numër jo të vogël poezish, shkrime publicistike, përkthime dhe plot shtatë tragjedi, gjatë një periudhe gati 20-vjeçare. Ajo që vihet re në kuadrin e veprës së tij, është një lloj dashurie e tij për temën e së kaluarës, madje të kaluarës së lashtë. Një numër lirikash, përkthimi i *Bukolikeve* të Virgjilit dhe, në mënyrë të veçantë, pjesa më e madhe e tragjedive të shkruara prej tij, dëshmojnë më së miri këtë prirje. Tragjeditë e tij jo vetëm që prekin tema e ngjarje të periudhës antike, por ndjekin në vija të përgjithshme dhe stilin grek të të shkruarit por me tendencën neoklasiciste këtë dukuri letrare që kish lindur në Francë në shek. XVIII dhe synonte të përtërinte artin e lashtë grek.

Sigurisht, në këtë punim nuk synojmë as të shpjegojmë dukurinë e neoklasicizmit dhe as parimet mbi të cilat ajo mbështetet.

Mjafton të përmendim faktin se dukuria në fjalë, nuk mbeti e panjohur nga krijuesit tanë të kohës ndër të cilët do të sjellim ndërmend Gjergj Fishtën, De Radën dhe Haxhiademin i cili na shfaqet në këtë kontekst si një zë origjinal dhe i vetëm në letërsinë shqipe. Siç e shprehëm, 7 janë tragjeditë e Haxhiademit: “Ulisi” shkruar në Berlin, më 1924, “Akili” shkruar në Vjenë më 1926, “Aleksandri” shkruar në Shqipëri, më 1928, “Pirrua” shkruar në Shqipëri e po ashtu dhe “Skënderbeu” shkruar më 1935, “Diomedi” shkruar më 1936 dhe “Abeli” shkruar më 1938.

Nuk mund të pretendojmë që brenda një punimi të bëjmë të mundur analizën e të shtatë tragjediave të Haxhiademit, as në planin tematik e përmbajtësor dhe as në atë artistik.

Ndoshta një ndihmesë e thjeshtë, në kuadrin e fjalës dhe mendimit për vlerësimin përgjithësisht të munguar, për Etëhem Haxhiademin do të qe një analizë e njëres nga tragjeditë e tij.

E parë më me interes që ndihmesën time ta jepja për tragjedinë “Abeli” nga shkrimet mësova se subjektin e kësaj tragjedie, Haxhiademi e ka nxjerrë prej kalesës së famshme të Testamentit të vjetër, Kapitulli IV i librit të parë të Moisiut ku kemi rrëfimin e mëposhtëm për djemtë e Adamit dhe të Evës, respektivisht Abelin dhe Kainin: “Edhe Adami njohu gruan e vet, Evën. Dhe ajo u ngjiti me barrë dhe lindi Kainin dhe tha: Unë fitova një mashkull me Zotin. Dhe ajo vazhdoi në këtë mënyrë dhe lindi Abelin, vëllan e tij. Abeli u bë bari dhe Kaini u bë bujk. Por ndodhi që, sipas zakoneve të asaj kohe, Kaini i solli fli zotit prej pemëve të arës. Ndërsa Abeli i solli prej qengjave të tufës së vet dhe bulmetit të tyre. Dhe Zoti pa me sy më të mirë flinë e Abelit. Ndërsa Kainin dhe flinë e tij nuk e pa me sy të mirë. Nga kjo Kaini u zëmërua tepër. Ndaj Zoti i foli Kainit: Pse zemërohesh ti? Dhe pse vrenjtësh në fytyrë? Po qe se ti beson, të duan. Po qe se nuk beson, faji qëndron para derës dhe të pret ty; por ti sundoje atë. Mandej Kaini i foli të vëllait, Abelit. Dhe kur qëllloi që u gjendën në arë, u ngrit Kaini kundër të vëllait dhe e vrau. Pastaj Zoti i foli Kainit: Ku është yt vëlla, Abeli? Ai u përgjigj: Nuk e di. Pse, unë do ta ruaj tim vëlla? Por zoti i foli: Çfarë bëre? Zëri i gjakut të tët vëllai, më thërret nga dheu!”¹

Do t’i bashkohesha edhe unë me mendimin e shumë kritikëve të cilët kanë bindjen se “Abeli” është kryevepra e Haxhiademit dhe njëkohësisht tragjedia më njerëzore e tij. Vetë autori, në shënimet e tij rreth kësaj vepre thekson se: “kjo është

¹ Etëhem Haxhiademi, “Parathanëja”, në *Abeli*, “Botimet Poeteka”, Tiranë, 2019, f. 7-8.

një vepër e shkruar për të demonstruar një tezë: edukimin e pabarabartë të fëmijëve në një familje që sjell përçarje”.²

Këtë mendim e mbështet edhe studiuesi Aurel Plasari, i cili duke cituar parathënien e tij të vitit 1938 shkruan mbi “edukatën e prindërve” dhe thekson se analiza nis nga familja. Dimensioi familjar, që shfaqet dhe përkon me parimin kristian, me sa duket të transmetuar prej judaizmit, simbas të cilit Mbretëria e qiellit fillon në familje”³. Jo vetëm ky pohim tepër logjik dhe i drejtë i autorëve por dhe vetë tragjedia dëshmon më së miri për këtë dukuri. Gjithë vepra nuk është gjë tjetër përveçse një apel i fuqishëm për drejtësinë e veprimit dhe baraspeshën e tij, në fushën e edukimit të fëmijëve. Nëse Haxhiademi e ka përqendruar ndikimin e këtij veprimi në gjirin e familjes, ne do të thoshim se ai vlen për të gjithë shoqërinë. Përderisa familja është celula bazë e shoqërisë njerëzore, dhe shoqëria një familje e madhe, atëherë rezultatet e gabuara dhe pasojat e dëmshme janë apo shfaqen edhe në planin shoqëror. Smira, ambicia e sëmure, krimi përhapen edhe në shoqëri ashtu si rrathët që formohen teksa hedh një objekt në ujë.

Të shkruarit e kësaj tragjedie nga Haxhiademi nuk qe trajtimi artistik i këtij fakti biblik (vrasjes nga Kaini të të vëllait). Përkundrazi, qëllimi është shumë më i rëndësishëm.

Madje vetë autori e pohon synimin tij në parathënien që shoqëron botimin e tragjedisë teksa thotë se synon “të ngas një plag shoqëror”.

M’u duk me interes të citoja pak nga një shkrim i Vangjo Nirvanës mbi këtë tragjedi ku ky kritik i njohur thotë se “Kainë dhe Abelër jemi nga një çik që të gjithë, kush më pak e kush më shumë.”⁴

² *Po aty*, f. 8 - 9.

³ Aurel Plasari, “Ideologjia e dashurisë përballë ideologjisë së urrejtjes”, *Nëntori*, No. 1, 1991, f. 79.

⁴ Shih në tekstin tek shënimet e V. Nirvanës “Abeli”, f. 110.

Një pohim i tillë nuk është thjesht vërtetimi i një pëlqimi personal. Përkundrazi, ai njëkohësisht është dhe një dëshmi e një dukurie aktuale dhe shembujt nuk mungojnë filluar që nga mërzitë e inatet deri tek grindjet dhe pse jo edhe krimet që rrënjët e tyre i kanë që nga edukimi jo i drejtë dhe nga qëndrimi i pabarabartë prindëror qysh në vitet e fëmijërisë.

Duke e parë tragjedinë e mësipërme të Haxhiademit në një plan më të gjerë, mund të shpjegojmë dhe mjaft plagë shoqërore duke arritur dhe në konfliktet e mëdha shoqërore, kombëtare e ndërkombëtare. Por këtë do ta quaja ose do ta vlerësoja si një pretendim të madh, si për momentin ashtu dhe për mundësitë tona e që, ndoshta i takon së ardhmes.

Duke u kthyer edhe një herë në tragjedinë Abeli, do të vinim theksin te vlera e madhe e tragjedisë në planin edukativ e shoqëror, tek synimi i autorit për të ngritur në pedestal një botëkuptim të ri mbështetur në një këndvështrim të afërt, që nënkupton dashurinë vëllazërore dhe që, më tej, rrezaton në dashurinë, miqësinë e bashkëpunimin mes popujve.

E kundërta nuk do të jetë as më shumë e as më pak se sa fjalët e Adamit:

*“Zilinë dhe nakarin prej vetiut
O Evë, i polli zemra e njeriut
Këto dy vese njerëzit i gënjejnë
Sa dhe dy vllazën në armiq i kthejnë !”⁵*

Nëse u përqendrova kryesisht te tragjedia “Abeli”, edhe këtu duke prekur disa nga çështjet e mendimit më kryesore të saj, pa prekur anën artistike të saj dhe gjithashtu pa folur për veprën tjetër të Haxhiademit, kjo nuk do të thotë se veç kaq mund të thuhet për këtë autor.

⁵ Etëhem Haxhiademi, *Abeli*, “Botimet Poeteka”, Tiranë, 2019, f. 17.

Përkundrazi, vepra e tij ka shumë vlera për të cilat mund të flasësh, si në aspektin përmbajtësor, ideor e artistik për të cilat është folur, po flitet e do të flitet e do të shkruhen edhe padyshim do të duhen faqe e emisione të tëra për t'i nxjerrë në dukje.

Punimin im, siç e vë në dukje, përfaqëson një ndihmesë të thjeshtë në këtë përpjekje që synon t'i jepet Haxhiademit vendi që meriton.

BIBLIOGRAFI

- Haxhiademi, Etëhem, *Abeli*, Botimet Poeteka, Tiranë 2019.
- Haxhiademi, Etëhem, *Lyra*, Botimet Poeteka, Tiranë 2019.
- Haxhiademi, Etëhem, *Ulisi*, Botimet Poeteka, Tiranë 2020.
- Haxhiademi, Etëhem, *Skënderbeu*, Botimet Poeteka, Tiranë 2020.
- Haxhiademi, Etëhem, *Abeli*, Botimet Poeteka, Tiranë 2019.
- Haxhiademi, Etëhem, *Bukoliket*, Botimet Poeteka, Tiranë 2021.
- Plangarica, Tomorr, *Univers i vlerave të munguara*, “Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, “Sejko”, Elbasan 2002.
- Plasari, Aurel, *Ideologjia e dashurisë përballë ideologjisë së urrejtjes*, “Nëntori”, No. 1, 1991